



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 27, datë 10. 11. 2014

PËR

**“DHËNIEN E MIRATIMIT PËR VENDOSJEN E BASORELIEVIT DHE PLLAKËS
PËRKUJTIMORE NË NDER TË KRYEMINISTRIT TË PARË JOKOMUNIST NË
VENDET E EUROPËS QENDRORE DHE LINDORE, TADEUSH MAZOVIECKI”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 10 pika 3/11 shkronja “a”, neni 32 shkronja “m”, neni 33 pika 2 të ligjit nr.8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); neni 31, paragrafi I i vendimit të Këshillit Bashkiak nr.31 datë 31.05.2004 “Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Tiranë” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Këshillit Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Dhënie e miratimit për vendosjen e basorelievit dhe pllakës përkujtimore në nder të kryeministrit të parë jokomunist në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, Tadeush Mazowiecki, me mbshkrimin në gjuhët shqip dhe polonisht:

**“TADEUSH MAZOVIECKI
1927- 2013**

Politikan i shquar polak

Kryeministri i Parë Jokomunist

në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore (1989- 1990)

Mik i popullit shqiptar”

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K r y e t a r i

ALDRIN DALIPI